



## FORMULARI MBI TË DREJTËN E AUTORIT TË KN CIGRE KO

Titulli i Punimit: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Komiteti Studiues: \_\_\_\_\_

Autor(ët)i: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

### PËLQIMI PËR PUBLIKIMIN E PUNIMIT DHE TRANSFERIMIN E TË DREJTËS SË AUTORIT

Unë/Ne si pronar(ë) i të drejtës së autorit të punimit të mësipërm, me anë të këtij pëlqimi dorëzoj (dorëzojmë) punimin te Sekretariati i KN CIGRE KO për publikimin e tij.

Me qëllim të përfshirjes së punimit të lartcekur në përmbledhjen e punimeve të Konferencës së KN CIGRE KO, unë/ne (individualisht dhe së bashku) nënshkruaj(më) si pronar(ë) i të drejtës së autorit në këtë punim. Pas pranimit të punimit tim(tonë) për publikim nga KN CIGRE KO, unë/ne si pronar(ë) dhe i/të autorizuar transferoj(më) të drejtën e autorit të punimit të lartpërmendur tek KN CIGRE KO sipas kushteve të përcaktuara në dispozitat e dhëna në këtë formular.

#### A. Për autorin kryesor:

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_ Datë: \_\_\_\_\_

Emri, mbiemri dhe adresa e autorit përgjegjës për komunikim me KN CIGRE KO

-----

Tel.: \_\_\_\_\_ E-mail: \_\_\_\_\_

#### B. Për një përfaqësues të autorizuar të një organizate që mban të drejtën e autorit:

Nënshkrimi i përfaqësues të autorizuar: \_\_\_\_\_

Në emër të organizatës: \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_\_

(Organizata)

Emri dhe adresa e organizatës:

-----

Tel.: \_\_\_\_\_ E-mail: \_\_\_\_\_

Ju lutemi, plotësoni të gjitha informacionet e kërkuara dhe bashkëngjitni këtë formular nëpërmjet platformës [www.cigre-ks.com](http://www.cigre-ks.com)

## **DISPOZITAT E TË DREJTAVE TË AUTORIT TË KN CIGRE KO**

Këto dispozita rregullojnë procedurën dhe kërkesat për publikimin e punimeve ose artikujve që duhet të dorëzohen në KN CIGRE KO për publikim. Formulari në anën e pasme të listës që rregullon miratimin për publikimin e punimeve dhe transferimin e të drejtës së autorit duhet të kompletohet dhe të kthehet në KN CIGRE KO.

1. Politika e KN CIGRE KO është që të ketë të drejtën e autorit për një kontribut teknik që publikohet në interes të KN CIGRE KO, autorëve të tij dhe punëdhënësve të tyre dhe për të lehtësuar përdorimin e duhur të këtyre materialeve nga të tjerët.
2. KN CIGRE KO publikon dhe shpërndan punime brenda vendit. Kur një punim dorëzohet për publikim në KN CIGRE KO, atëherë pranimi i saj nënkupton automatikisht që KN CIGRE KO ka të gjitha të drejtat që lidhen me to, në përputhje me ligjin dhe këto Dispozita.
3. Lidhur me punimet e dorëzuara, KN CIGRE KO zbaton politikat e mëposhtme: KN CIGRE KO ofron prezantimin dhe paraqitjen e materialeve të punimeve në kuadër të Konferencës, publikimin e tyre, si dhe qasjen e përdoruesve në këto punime si aktivitete që shërbehet nga KN CIGRE KO. Nëse publikimi i punimeve të paraqitura kërkon pëlqimin e palëve të tjera, atëherë kjo është përgjegjësi e autorit për ta dhënë atë e jo e KN CIGRE KO.
4. Nëse e drejta e autorit për të paraqitur punimin i takon autorit (autorëve), atëherë pëlqimi për publikim duhet të nënshkruhet nga autor(ët) në formën nën A, duke vënë njëkohësisht edhe datën.
5. Nëse autori i takon një organizate që e punëson autorin ose është një punë që lidhet me veprimtarinë e asaj organizate, atëherë pëlqimi për publikim duhet të nënshkruhet nga një përfaqësues i organizatës, në formën nën B, duke vënë njëkohësisht edhe datën.
6. Autor(ët) dhe / ose organizata që kanë dhënë pëlqimin për transferimin e të drejtës së autorit kanë këto kompetenca:
  - të mbajë të gjitha të drejtat e pronësisë përveç të drejtës së autorit, sikurse që janë të drejtat e patentës;
  - për të riprodhuar imazhet dhe performancat nga punimi me njoftimin paraprak dhe në kohë të Sekretariatit të KN CIGRE KO.
  - që të ripërdorë në tërësi ose pjesërisht punimin me qëllim të kryerjes së punimeve të tjera;
  - pa pagesë mund të kopjojnë punimet e botuara /publikuara për nevojat e tyre, por jo për shitje, me kusht që ata të mos thirren në emër të KN CIGRE KO që mund të sugjerojnë promovimin e disa produkteve, shërbimeve apo prodhuesve të caktuar nën simbolin e KN CIGRE KO.
7. Nëse punimi nuk pranohet, atëherë e drejta e autorit të punimit i mbetet autor(ëve)it origjinal. Nëse punimi pranohet mirëpo nuk publikohet brenda një periudhe të arsyeshme pas pranimi, atëherë autor(ët) ka (kanë) të drejtën të kërkojë (kërkojnë) që KN CIGRE KO të rikthen të drejtën e autorit tek autor(ët) origjinal.